

12 Korrik, 2024

Drejtuar: **Z.Fatmir Xhafaj**
Kryetar i Komisionit Parlamentar

Subjekti: Kthim përgjigje shkresës nr 2747, datë 08.07.2024 me lëndë "Ftesë për Bashkëpunim"

I nderuar,

IDRA duke vlerësuar ftësën tuaj për bashkëpunim, shpreh mirënjohje dhe falenderime të veçanta për konsideratën ndaj punës, kontributin dhe ekspertizës tonë për të bashkëpunuar me Komisionin e Posaçëm Parlamentar "Për thellimin e reformave të mirëqeverisjes, sundimit të ligjit dhe antikorrupsionit për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian".

IDRA ka kënaqësinë të propozojë Z. Auron Pasha, si ekspert në fushën e antikorrupsionit dhe Znj. Blerta Kalavace si profesioniste me eksperiencë në fushën e mirëqeverisjes si ekspertë në Grupet e Ekspertëve apo pjesë të Sekretariatit Teknik që do të ngrihet pranë këtij Komisioni.

Përgjatë pesë viteve të fundit IDRA është angazhuar në fushën e mirëqeverisjes në nivel qëndror dhe vendor duke punuar me transparencës e qeverisjes, performancën e qeverisjes vendore dhe këshillave bashkiakë, implementimin e reformës në shërbimin civil përgjatë administratës shtetërore, reformën e përmirësimit të shërbimeve publike, standardet e shërbimeve publike, vlerësimin e gatishmërisë dixhitale të bashkive, qeverisjes elektronike, korrupsionit në Universitete etj.

Po ndajmë me ju në këtë kthim përgjigje publikimin tonë për [Studimin e perceptimit të korrupsionit në universitete dhe parandalimin e tij](#) së bashku me studimin e [World Justice 2023](#), ku IDRA ka kontribuar nëpërmjet Znj. Kalavace.

Për të gjitha të dhënat dhe dokumentat e tjerë të përmendur më sipër IDRA do procedojë me marrjen e pëlqimit paraprak nga klientët për tua vendosur në dispozicion në vijimësi.

Duke Ju falenderuar paraprakisht,

Auron Pasha

